



Data: 11/09/2020 Ref.: 1574/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet akreditimi i programit të studimit të Kolegjit Dardania:
 - Administrim Biznesi dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit të cekur në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Dardania, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të programeve të studimit.

Sa i përket programit të studimit të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë ka konstatuar se ky program përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht nuk ka rekomanduar akreditimin e tij. Për programin e studimit Administrim Biznesi dhe Ekonomiks, BA 180 ECTS, në kapitullin që lidhet me misionin, objektivat dhe administrimin, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se nuk ka ndërlidhje ne mes të misionit të programit dhe misionit të institucionit. Për më tepër, misioni i programit nuk është i bazuar në konceptet

bazë të cilat janë: lidhshipi në profesion, menaxhimi i praktikës, zgjerimi i njohurive, ballafaqimi me sfidat etj.

Sa i përket Menaxhimit të Cilësisë ekspertët theksojnë se nuk ka procedura të formalizuara me të cilat sigurohet përfshirja e të diplomuarve brenda procesit të politikbërjes apo çfarëdo aktiviteti tjetër institucional. Institucioni ka dorëzuar një plan për vlerësimin e mësimdhënësve, plan i cili nuk ka të inkuorporuar as pjesën e hulumtimit, dhe as atë të didaktikes dhe metodave të mësimdhënies. Ndonëse institucioni ka treguar disa dëshmi se ata organizojnë trajnime të stafit dhe mësimdhënësve, ata kanë dështuar të tregojnë një agjendë i cili tregon përmbajtjen e trajnimit apo rezultatet e të nxënit.

Sa i përket stafit akademik, ekspertët theksojnë se ka informacione jo konsistente në lidhje me publikime shkencore dhe hulumtim. Ndonëse kolegji pretendon se stafi akademik publikon në revista shkencore, në evidenca këta persona nuk janë bartës të projektit apo disa prej tyre nuk rezultojnë si pjesë e stafit akademik të kolegjit. Ekspertët kanë vërejtur edhe informacione të pasakta të cilat janë prezantuar në Raportin e Vetëvlerësimit, në të cilin disa persona paraqiten si staf full time, por që në CV-të e tyre ata janë full time në institucione të tjera.

Procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies është vërejtur të ketë kontradikta pasi në njërin anë Kolegji Dardania pretendon se kanë një sistem interaktiv të metodave të të mësuarit, por në anë tjetër RVV e identifikon këtë element si një dobësi të kolegjit. Ekspertët kanë vërejtur se theks i veçantë i kushtohet pajisjeve të të mësuarit, por kolegji nuk i kushton rëndësi elementit kryesorë e që është metodat e mësimdhënies. Rezultatet e të nxënit gjithashtu janë shumë të limituara. P.sh. disa lëndë të rëndësishme përmbajnë vetëm 3 rezultate të të nxënit.

Sa i përket hulumtimit, ekspertët theksojnë se nga lista prej 3 persona të cilët kanë publikuar hulumtime, në fakt vetëm njëri prej tyre është pjesë e Kolegjit Dardania, po që edhe ai është vetëm staf part time. Prandaj pretendimi i Kolegjit Dardania se stafi akademik merr pjesë në mënyrë aktive në hulumtim nuk është i saktë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Dardania
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.



G. Luboteni

Pror. D. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë